



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER LORENC V. DAKA
ADRESA BLV'GJERGJ FISHTA', p.
nr.6, zyra nr.17
TEL: 0696557338

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1027

Nr. koleksioni: 489

Tirane më 17/03/2022

/L

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 10/12/2018 "Për Notarinë"



A2022053070052611306



KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(TË SHOQËRISË "SMART - CONSTRUCTION" SH.P.K)

Sot, më datë 17.03.2022, para meje Noter LORENC V. DAKA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, BLV'GJERGJ FISHTA', p. nr.6, zyra nr.17, u paraqit personalisht:

SHITES: Arian Tartari, atësia Servet, amësia Faikate, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Vllazën Huta; Nd. 10; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1010; Tiranë, lindur më 17/02/1966, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Biometrike nr. BR7777646 dhe nr. personal G60217148R.

BLERES: Ervin Tartaraj, atësia Bashkim, amësia Fotinë, shtetas Shqiptar, lindur në Kallarat, Vlorë dhe banues në VLORË, me adresë Evgjëni Shtrepi 04140105; Nd. 4; H. 1; Vlorë; Vlorë; 9402; Vlorë, lindur më 26/08/1979, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Biometrike nr. BB1750092 dhe nr. personal H90826146W.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "SMART - CONSTRUCTION" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Ekzistojne keto kushte paraprake:

- Shoqëria "SMART-CONSTRUCTION" Sh.p.k. është një Shoqëri që vepron sipas së drejtës shqiptare, e regjistruar pranë QKR si Person Juridik me nr. NUIS L82231033A, me Ortakë të vetëm të shoqërisë Z. Arian Tartari, zoteruesë e 1 kuote ose 100 % të kuotave.
- Kapitali i shoqërisë "SMART-CONSTRUCTION" Sh.p.k është 100.000 leke (një qind mijë leke) i zotëruar ky nga ortakët e vetëm të shoqërisë në bazë të zoterimit të kuotave përkatëse.
- Me Vendimin e dt.16.03.2022 të ortakut të vetëm, është vendosur shitja e pjesëve të kapitalit të shoqërisë dhe të aseteve në masën 50 %, ose 1 kuote që zoteron pronari i saj Arian Tartari në favor të palës blerëse z.Ervin Tartaraj.

Per sa me sipër Palët e kësaj Kontrate Shitjeje Kuotash kanë rënë dakord:

1. Shitesi Arian Tartari i shet blerësit Ervin Tartaraj 50 % të kuotave kapitalit të shoqërisë, ose 1 kuote (1 pjesë). Vlera e shitjes së pjesëve të kapitalit të përmendura në këtë është 50.000 leke (pesëdhjetë mijë leke).
2. Vlera e shitjes së përmendur me sipër është paguar plotësisht nga Blerësi dhe nuk ka pretendime të tjera mes palëve.



A2022053070052611306

3. Me realizimin e kesaj Kontrate shitesi zhvishet nga pronesia e 50 % te kuotave te kapitalit, e cila perben 1 kuote (1 pjese) te kapitalit te shoqerise "SMART - CONSTRUCTION" Sh.p.k dhe asetete te saj dhe keto kuota dhe asetet e kesaj shoqerise kalojne ne pronesi te bleresit Ervin Tartaraj, duke u bere zoterues i 50 % te kuotave te kapitalit ose 1 kuote (1 pjese).
4. Me perpilimin e kesaj kontrate ortakët zoterues i të gjithë kapitalit dhe kuotes te shoqerise do te behen Arian Tartari zoterues i 1 kuote (1 pjese) te shoqerise, e cila perfaqeson 50 % te kapitalit te shoqerise dhe Ervin Tartaraj zoterues i 1 kuote (1 pjese) te shoqerise, e cila perfaqeson 50 % te kapitalit te shoqerise.

BAZA LIGJORE

- 3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- 3.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
- 3.3 Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

ANEKSET E KONTRATËS

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneksë të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve me nr. 1, date 16.03.2022
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë "SMART-CONSTRUCTION" Sh.p.k., datë 16.03.2022;
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese,

NENI 13

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

13.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

13.2 Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

13.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITES

Arian Tartari

Arian Tartari

BLERES

Ervin Tartaraj

ERVIN TARTARAJ





“SMART- CONSTRUCTION” SH.P.K.

VENDIM I ORTAKUT TE VETEM

TË SHOQËRISË “SMART-CONSTRUCTION” shpk

Nr.1

Në Tiranë sot me dt. 16.03.2022, në selinë e Shoqërisë “SMART-CONSTRUCTION” shpk., me seli në Tiranë, me NIPT L82231033A, u mbledh rregullisht Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë “SMART-CONSTRUCTION” sh.p.k duke respektuar procedurat e parashikuara në Ligjin 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” ku ishte i pranishëm Ortaku i vetem i shoqërisë i cili deklaroi mbledhjen e hapur pasi u verifikua prezenca e Ortakëve si më poshtë;

1. ARIAN TARTARI zoteruesi i 100 % të kuotave të shoqërisë “SMART-CONSTRUCTION” shpk. dhe meqënëse prezent ne mbledhje Ortaku i vetem i shoqërisë, vazhdohet në lidhje me rendin e ditës si më poshtë vijon;

Meqënëse ne kete mbledhje eshte i pranishem ortaku i vetem i shoqërisë dhe kuorumi i nevojshem per marrjen e Vendimeve te vlefshme eshte realizuar e deklaroi ate te hapur dhe paraqiti rendin e dites si me poshte:

Kalimin e pronësive të 50 % të kuotave ose 1 kuote (1 pjese) te shoqërisë SMART-CONSTRUCTION shpk nepermjet shitjes nga ortaku Z. ARIAN TARTARI tek BLERESI Z. ERVIN TARTARAJ.

Pas diskutimeve te ortakeve mbi rendin e dites ata unanimisht dhe me vullnetin e tyre te plote dhe te lire:

VENDOSEN

1. Kalimin e pronësive të 50% të kuotave te shoqërisë SMART-CONSTRUCTION shpk nepermjet shitjes nga ortaku Z. ARIAN TARTARI tek bleseri Z. ERVIN TARTARAJ.
2. Ortakë te shoqërisë SMART-CONSTRUCTION shpk do te jene z. ARIAN TARTARI, zoterues i 50 % te kapitalit ose 1 kuote dhe z.ERVIN TARTARAJ zoterues i 50 % te kapitalit ose 1 kuote.

Pasi nuk pati ceshtje te tjera per te diskutuar ortaku I vetem vendosi depozitimimin e ketij Vendimi prane Zyres se Regjistrimit te Shoqërive Tregtare dhe deklaroi mbledhjen e mbyllur.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË “SMART-CONSTRUCTION” SH.P.K.

ARIAN TARTARI



Arian Tartari
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER LORENC V. DAKA



DATE 17/03/2022
NR REP 1026

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 17.03.2022, para meje Noter LORENC V. DAKA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, BLV'GJERGJ FISHTA', p. nr.6, zyra nr.17, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES: Arian Tartari, atësia Servet, amësia Faikate, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Villazën Huta; Nd. 10; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1010; Tiranë, lindur më 17/02/1966, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033880771 dhe nr. personal G60217148R ne cilesine e Ortakut te vetem te Shoqërise "SMART CONSTRUCTION" shpk, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të biznesave) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS L82231033A, me seli me adresë Rruga 'ismail Qemali', Samos Tower, Kati 5, Njesia Administrative Nr. 5.

Subjekti i mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noterit, "Vendimin e Ortakut te vetem te shoqerise "Smart-Construction"shpk, Nr. 1, date 16.03.2022", bashkëlidhur.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
LORENC V. DAKA

PULLE TARIFE

